



**AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA**

Student's Center, 2nd floor, 10000 Prishtina, Kosovo, tel. +381 38 213722, fax +381 38 213087
www.akreditimi-ks.org, email: kaaoffice@gmail.com

Nr.

Dt.

Kosova pranohet në ENQA

Asociacioni Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ENQA ka konfirmuar anëtarësimin e plotë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) në këtë organizatë për një periudhë 5 vjeçare. Ky vendim vjen pas takimit të fundit të Bordit të ENQA-s më 15 shtator 2014. Konfirmimi i pranimit të anëtarësisë së plotë pason pas vizitës së panelit ndërkombëtarë në AKA dhe vlerësimit të tyre mbi punën e saj gjatë muajit janar 2014.

Pranimi i Kosovës në ENQA kontribon në avancimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe ofron mundësi për ndërlidhjen e institucioneve dhe studentëve tanë në sistemin evropian të arsimit të lartë.

Anëtarësimi i plotë i AKA-së në ENQA konfirmon profesionalizmin e saj në implementimin e standardeve dhe praktikave më të mira evropiane në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

ENQA është krijuar pas rekomandimeve të Bashkimit Evropian për të promovuar Procesin e Bolonjës. Asociacioni kontribon në zhvillimin e cilësisë në arsimin e lartë në vendet që janë nënshkruese të marrëveshjes së Bolonjës.

Prishtinë

25.09.2014

Ferdije Zhushi – Etemi, Kryetare

Këshilli Shtetëror i Cilësisë